



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01 Nr 40005-52413  
Datë: 01.10.2025

Kryetari i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (a) dhe (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenit 13 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit Vlerësues për Ndarjen e Bursave Komunale të Komunës së Gjakovës për vitin akademik 2024/2025, më datë 01.10.2025, merr këtë:

### V E N D I M

1. Miratohet rekomandimi i Komisionit Vlerësues për Ndarjen e Bursave Komunale për studentët e Komunës së Gjakovës për vitin akademik 2024/2025, sipas regjistrimit me të dhënat e bashkangjitura në këtë vendim.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të realizoj procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerën totale prej 60,000.00 € nga fondi i subvencioneve të Drejtorisë për Arsim, me të cilat do të mundësohet pagesa e bursave për njëqind (100) studentë të evidentuar në procesverbalin e komisionit dhe në listën e bashkangjitur të këtij vendimi.
3. Përfituesit e bursave për vitin akademik 2024/2025, duhet të nënshkruajnë kontratë me Drejtorinë e Arsimit me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve si lartësia e bursës, mënyra e pagesës, si dhe kriteret për vazhdimin e bursës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

#### Vendimi i' u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Arsim
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

